

## TE ARBËRESHËT E ITALISË

Shtator, 2018

Me ftesë të **komunitetit arbëresh në Itali**, nga *Qendra e Studimeve të Traditave Arbëreshe, “Skander” – Fogjio dhe të Komunës Kasalvechio të Rajonit të Pulias*, mora pjesë në veprimtarinë kulturore **“Vëllazëria 2018”**, që shënonte edicionin e dytë (pas atij të vitit 2017). Slogani **“Vëllazëria”** i bënte jehonë lidhjeve miqësore midis **komunitetit arbëresh në Itali** dhe **shqiptarëve kudo në botë**.

**Kjo veprimtari u mbajt për tri ditë, 21-23 shtator 2018, në katundin arbëresh Kasalvechio të Pulias.**

**“Vëllazëria 2018”**, që ishte përjetuar **në kuadrin mbarëkombëtar të Vitit të Skënderbeut**, përfshinte edhe **konferencën shkencore** kushtuar Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeu, si edhe kumtesat për **traditat arbëreshe**. Në këtë konferencë, që i zhvilloi punimet për dy ditë në sheshin *“Papa Pio”* të Kasalvechio të Pulias, mbajta edhe unë një kumtesë. Duke qenë se kumtimi përbënte angazhimin tim parësor në **veprimtarinë “Vëllazëria 2018”**, po e parashtroj atë sipas përmbajtjes përkatëse me titull: **“Hulumtime tek arbëreshët e Italisë dhe rituali i martesës (1990-2003)”**<sup>1</sup>

Përmes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ku kam punuar si **punonjës shkencor për 38 vjet (1967-2005)**, duke qenë i vetëm ose me kolegë (kryesisht me Prof. Agron Xhagollin), kam kryer hulumtime në **27 katunde** nga pesë rajone arbëreshe të Italisë.

Konkretisht në:

1. **Kalabri** (me qytetin kryesor Kozencën): *Ungra, Firmoza, Ferma, Ejanina, Frasnita, Çifti (Çivita), Shën Benedikti Ullanova, Shën Mitri, Shën Sofia, Mbuzati, Kastërnexhi, Farneta, Strigar, Vakarici, Pllatini, Maqi, Shën Vasili dhe Spixana.*

<sup>1</sup> Kumtesa u mbajt me shkurtime dhe pa pesë fotografite përfshirëse. Për më gjerë, për këtë kumtesë shih vëllimin tim *“Diaspora Etnokoreografike, Tiranë, 2013, kapitulli i dytë, me titull “Hulumtime etnokoreografike në pesë rrethime të Italisë së Jugut me ngulime arbëreshe”*, f. 83-238.

2. **Bazalikate** (me qytetin kryesor Potencia): *Shën Konstandini Arbëresh dhe Shën Pali*.
3. **Pulia** (me qytetin kryesor Foxhia): *Kieuti*.
4. **Molise** (me qytetin kryesor Kampobaso): *Ururi, Portkanuni, Këmarini dhe Munxhifuni*.
5. **Siçilia** (me qytetin kryesor Palermo): *Hora e Arbëreshëve, Shën Kristina ose Sëndastina dhe Kundisa*.

Si rrjedhojë e një pune trembëdhjetëvjeçare, gjatë periudhës 1990-2003, sigurisht që është mbledhur një lëndë e pasur arbëreshe. Krahas filmimeve dhe fotografimeve në terren kemi zhvilluar edhe bashkëbisedime të pafundme, duke vjelë dukuri tradicionale, në përgjithësi, dhe etno-koreografike, në veçanti.

Lënda e hulumtuar ndodhet e sistemuar shkencërisht në *Arkivin e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë*. Gjithashtu, ajo ka gjetur jetë në botimet shkencore, duke përfshirë edhe **20 vëllimet e mia**.

Sipas itinerarit të hulumtimeve në terren, duke ndjekur rendin kronologjik, ato nisin në vitin 1990, për më shumë se një muaj, në katundin Kieuti të Pulias, që përbën **vendndodhjen e parë**. Isha i ftuar (së bashku me kolegun *Kujtim Shkreli*), nga shoqata kulturore “Gjaku i shprishur”, Kieuti, me President **Prof. Mario Massaro**. Sondazhe të pjesshme u përqendruan edhe në katundet *Këmarin dhe Ururi*, të rajonit Molise.

Dy vite në vijim (1992) është kryer **vendndodhja e dytë**, e përqendruar për disa ditë në katundet *Shën Mitri dhe Mbuzat*.

**Vendndodhja e tretë** i takon vitit 1993, përmes ekspeditës kërkimore – shkencore së bashku me *Prof. Xhagollin dhe Robert Çollakun*. Për më shumë se një muaj, hulumtimet u përqendruan në Kalabri dhe Sicili, në katundet: *Ururi, Akuofirmoza, Ferma, Ejaninë, Frasnite, Civita, Shën Benedekti Ullanova, Shën Sofia, Strigar, Mbuzat, Horë e Arbëreshëve, Sendastine dhe Kundisa*.

Me këtë rast do të theksoja rezultatet e ekspeditës: u incizuan dhe u filmuan **119 këngë, 48 njësi vallëzimesh, biseda informative, 150 fjalë të urta, disa përralla, legjenda e ndonjë gjëgjëzë; u zhvilluan 4 filma fotografikë dhe disa kasete filmike**. U punua me 91 bartës, burra, gra dhe fëmijë, ku do të veçoja: *Demarka Pepinja, Xhovanina Kaureli, Xhulio Manxo, Gianbatista Renes, Alfredo Frega, Pietro Kaporeli, Rozella Denis, imzot Emanuele Xhordano, Xhudiqe Domenika* (98 vjeçare), *imzot*

*Antonio Trupo, imzot Giuseppe Aleksandrini, Mikele Bafa, Margarita Qefalia, Katerina Mandele (94 vjeçe), Tomasina Guarina etj.*

Gushti i vitit 2000 shënon **vendndodhjen e katërt** tek arbëreshët e Italisë. Isha i ftuar me kolegë, përmes Akademisë së Shkencave në katundin *Çivita të Kalabrisë*, për të ndjekur:

1. Konferencën Ndërkombëtare për Folklorin Arbëresh.
2. Festivalin e Parë Euromesdhetar i Muzikës dhe Valles Arbëreshe.

Në konferencë mbajta kumtesën me titull "*Gjurmë kërcimesh nga toka amë*" (*Vallet arbëreshe në Kalabri dhe Siçili*). Në këtë kumtesë kam pasur objekt analizash vallet: "*Skënderbeku një me natë*", "*Konstandini e Jurendina*", "*Mbickë*", "*Valle me karamunxë*", "*Valle me drapër*", "*Vallja e karnavaleve*", "*Tarantela arbëreshe*", *vallet e kënduara*: "*Vjet për vjet na vjen kjo festë*" (*Vallja e pashkëve*), "*Gualjarni vjershën*", "*Zemë vallen*", "*Mori mollë*".

Me këtë rast (gusht 2000), së bashku me **Prof. Xhagollin**, zhvilluam edhe hulumtime në katundet: *Shën Kostandin, Kasternexhi, Fernate, Shën Pali, Shën Kozma, Vakariçë dhe Platini*.

U punua me 24 bartës, ku do të veçoja: imzot. Andrea Trupo, Antoneta Bresha, imzot. Lorenzo Foristjeri, Ruzina Demetja, imzot. Pjetro Minishi, imzot. Vinçenco Salvatore, Kalorota Karmenja etj.

Viti 2003 do të shënonte **vendndodhjen e pestë** te arbëreshët e Italisë. Përmes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ishim të ftuar nga *Qendra e Studimeve dhe Kërkimeve të Traditave Popullore Arbëreshe*, me president **Italo Elmo**.

U ndodhëm të pranishëm në komunën e katundit **Strigar** (5-9 gusht 2003), për të ndjekur dy veprimtari shkencore që ishin:

1. Konferenca ndërkombëtare "Muzika dhe kultura tradicionale arbëreshe: kërkimet dhe perspektivat e tyre"
2. Festivali i Dytë Euromesdhetar i Muzikës dhe i Valles Arbëreshe.

Pata nderin që në veprimtarinë e parë isha i zgjedhur si **president i konferencës** kurse në të dytën si kryetar i jurisë.

Gjatë konferencës mbajta kumtesën me temë "*Tri valle dasme arbëreshe*" ku pata objekt vallet: "*Juventina na martohet*", "*Tue shkundur mjendullën*" dhe "*Zëmi vallen*".

Pikërisht, nga Festivali i Dytë Euromesdhetar i Muzikës dhe Valles Arbëreshe (Strigar, 2003) e ka të bazuar lëndën kumtesa "*Rituali i martesës arbëreshe*".

Kjo kumtesë po mbahet për herë të parë pas 15 vitesh, ngase ka qenë e përgatitur për konferencën shkencore, në kuadrin e organizimit të *Festivalit të Tretë Euromesdhetar të Këngës dhe Valles Arbëreshe*, e cila ishte programuar të mbahej në katundet Çivita dhe Frashineto, më 8 – 12 dhjetor 2004. Në këtë kohë, sipas ftesës përkatëse, u përgatit kjo kumtesë, por që nuk u mbajt, ngase konferenca dhe festivali nuk u zhvilluan. (Kumtesa mbahet e përshtatur edhe me ndonjë konceptim të ri).

Sipas përmbajtjes së kumtesës *“Rituali i martesës arbëreshe”*, trajtesat e martesave në **Festivalin e Dytë Euromesdhetar të Muzikës dhe Valles Arbëreshe**, u shtjelluan me kahje etnografike, sipas disa etapave të caktuara kohore. Zhvillimi i tyre përmes ndërthurjeve me këngë e valle krijoi një atmosferë më përjetuese dhe emocionale, gjë që ngjalli interes të veçantë. Në këtë hapësirë, brenda caqeve të një kumtimi, do të bëjmë objekt ritualet e martesës që u trajtuan nga disa **ansamble arbëreshe**.

Përshtypje shumë të mira la ansambli *“Vjershëtarët”* nga Shën Sofia, i cili përmes një përgjithësimi arbëresh të ritualit të martesës, pati edhe grimca e nuanca unikale përfaqësimi, nga katundi objekt. Paraqitja e ritualit të martesës nga ky ansambël ishte organizuar në formën e një montazhi. Si në të shumtën e ansambleve, edhe në këtë rast, pjesëmarrja ishte me gra të moshuara, por edhe vajza e djem. Kënga *“E mbrëma e mirë, mirë se ju comi! / E mbrëma e mirë se na vini!”*, i uronte mirëseardhjen dasmorëve për martesën e çiftit. Nga ky ansambël ngjalli interes ceremoniali i përgatitjes së *“bilies”* (bijës për nuse), që u shtjellua me ritin arbëresh *“Ngreu nuse, unju nuse”*. Këtu, veç veprimeve mizanskenike, pati përcjellje me këngë nga katër gra. Interesant qe edhe veprimi i grave *“rrufiane”*, siç përcaktohen ato që shkojnë derë më derë për të *“lipur dorën e biljes”*. Nga ansambli *“Vjershëtarët”* i Shën Sofisë, ngjalli kërshtëri pasazhi i serenatës, ku dy djem të veshur me pelerina, këndojnë në formë *akapelo* poshtë dritares së çiftit të porsamartuar.

Nga disa ansamble me folklor burimor pati interes të madh riti *“Çami kulaçin”*, që zhvillohet në ditët e para të pasmartesës. Ky rit, që sipas traditës vendase simbolizon shtratin e martesës, zhvillohet nga nusja dhe dhëndri duke *“çarë kulaçin”*, ku nusja e mban atë me të dy duart, kurse dhëndri vetëm me një dorë. Shtjellimi bëhet në formën e një *“garimi”*, se kush do të shkëpusë me shumë pjesë nga kulaçi, që arbërisht thuhet: *“Kish shartin më të mire, kush mirr më shumë”*. Të pranishmit përreth manifestojnë me gaz e hare, duke kënduar: *“E sonte na çami kulaçin / E një drudhës mos e maçit / E ju mungu kini e provoni / Pare e çami e pra shomi”*.

Ndër *ansamblet* që i bëjnë jehonë ritualit të martesës, do të dallonim “*Vjershëtarët*” nga Maqi, me këngët “*Ngreu ti nuse*” dhe “*Moj ti zemër, moj ti mollë*”, të cilat u kënduan në formë *akapelo*, nga një grup grash të moshuara.

Atmosferën e ritit të stolisë, përgatitjes së veshjes së nuses dhe frizurës në përgjithësi, e solli ansambli “Dhëndurit e Arbërit” nga Hora Arbëreshe. Ndërmjet të tjerash, ai interpretoi një këngë që i bënte jehonë pagëzimit të çiftit. Veprimet mizanskenike, kostumet arbëreshe dhe përcjellja dinjitoze e orkestrës, manifestuan në këtë këngë një bukuri të veçantë. Gjithashtu, ansambli “*Shqiponjat*” i Shën Sofisë, me ritet “Të enjëten e nuses” dhe “Të premëten e samarit”, të cilat u përcollën me veprime mizanskenike, këngë dhe kërcime, pati realizime interesante që u pëlqyen shumë nga të pranishmit.

Nga *ansamblet* me folklor burimor kishte edhe shtjellime inskenuese me këngë e kërcime për rite të tilla si: përgatitja e shtratit (që arbërisht thuhet “Kur arrovjin te shpia e re, ndreqjin gjithësej edhe shtratin”); ardhja e dhëndrit për herë të parë të shtëpia e nuses (“kur qaset dhëndëri i lpen çdo, ndëse nusen o skamandilin”); pjesa e shamisë së nuses, ku dhëndri përgjigjet se “*do mparë fëmiljen, pra nusen e ndë fund skamandilin*”); apo riti kur “ndrrohen tri herë unazat e kurorat”.

Jehonën e ritualeve të martesës e solli edhe ansambli i Institutit të Bashkuar nga Frasnita, me “*Ritin e përgatitjes së vajzës që bëhet nuse*” dhe ansambli “*Dielli*” nga Mungrasano, me “*Ritin e bërjes nuse*”.

Ritualet e ceremonialit të martesës në festivalin e dytë shkëlqyen më së shumti përmes “**Dasmës së Strigarit**”, e cila u zhvillua në rrugët dhe sheshet e katundit, pra në natyrë, ditën e parë të hapjes së festivalit. Ishte si një mirëseardhje manifestuese për miqtë e shumtë, me qindra vetë, që e përcollën atë me këshërëri dhe emocione të mëdha. Çdo ritual i martesës u paraqit mirë dhe bukur, deri aty, sa nuk besohej të ishte një përshtatje riprodhuese, por një dasmë e vërtetë. Pjesëmarrësit e shumtë, pothuajse tërë banorët e katundit të Strigarit, duke qëndruar në pika të caktuara ose duke ecur nëpër rrugicat dhe shtëpitë karakteristike, me ato veshje të larmishme kryesisht të grave arbëreshe, sollën një mori ritesh të martesës, si: “*Zënia e brumit*”, “*Marrja e nuses*”, “*Pagëzimi i çiftit në kishë*” e shumë të tjera. Të lëvizurit e pjesëmarrësve përmes pasazheve me doke e zakone tradicionale arbëreshe, këngët përcjellëse që u kënduan me aq patos nga gra të moshuara, apo e gjithë ajo orendi shtëpiake tradicionale me **magje, qilima, zjarre, shtrëtrë, sëndukë** e tjera, të cilat u bënin jehonë *riteve të martesës*, kryesisht “çiftit – të porsamartuarve”, u kryen me origjinalitet të

madh, duke shkrië me to organikisht edhe të ftuarit e shumtë, shikuesit, të cilët ngjasonin si **krushq dhe dasmorë të vërtetë**.

Ishte kjo paraqitje mahnitëse, me atmosferën e një përgjithësimi të dasmës së martesës arbëreshe, si edhe, në njëfarë mase konkurrimi i ansambilit folklorik të katundit Strigar, arsyeja që juria e nderoi Strigarin me çmimin më të madh të festivalit, *“Flamurin e Arbëreshëve”*.

Kur kemi në objekt ritualet e martesës, kurrsesi nuk mund të anashkalojmë edhe disa këngë e valle që i bënin jehonë atij ceremoniali. Ansamblet që interpretuan njësi të tilla, ishin: *“Vjershëtarët”* nga Ejanina, me këngën *“Zgjoju nuse”* dhe vallen *“Zëmi vallen”*; ansambli *“Vjershëtarët”* nga *Shën Mitri*, me tri këngë ku do të veçonim: *“Sot me nat dita m'u di”*; ansambli *“Shkreptimat”* nga *Shën Vasili*, me këngët *“Bashkë detit”* dhe *“O kopile”*; ansambli *“Zjarri i zemrës”* nga Ferma, me këngët *“Motra ime”* dhe *“Zgjoju nuse”*; ansambli *“Kamastra”* nga Munxhufuni, me këngën: *“Çe isht i bukur ki dhëndri; / E kjo nusja isht ghian mialt”*; ansambli *“Ullania”* nga Shën Benedikti, me vallen *“Jurendina na martohet”*; ansambli *“Bashkë me Ylzat”* nga Ferma, me këngën *“Ish një vashëz në ragjeto”* (tarracë) etj.

Në përfundim, do të theksonim se ritualet e martesës u ndoqën me kërshëri të madhe në *Festivalin e Dytë Euromesdhetar të Këngës dhe Valles Arbëreshe, zhvilluar në katundin Strigar të Kalabrisë*. Ato shënuan kulme, sepse zbuluan vlerat më origjinale dhe estetike të tharmit të folklorit vendas. Artistët popullorë interpretuan me brishtësi, emocionalitet dhe kulturë artistike, duke i transmetuar këto rituale me një karakter të theksuar spektakolar. Sikundër u vu re edhe përpjekja për ta ruajtur të pastër **kulturën autentike vendase, arbëreshe**.

Tiranë, 19 gusht 2018

\*

Në vijim do të bëj objekt vështrimi përgjithësues zhvillimet në katundin Kasalvechio të Pulias të veprimtarisë kulturore **“Vëllazëria 2018”**.

Në këtë event qenë të ftuar nga Shqipëria edhe Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, Dr. Fatos Daci, Albert Koni, Leka Rudho etj. I ftuar ishte edhe ansambli folklorik shqiptar *“Miqësia”*, me President Hidajet Hortën. Gjithashtu, pati përfaqësues edhe nga qyteti i Lezhës, binjakëzuar me qytetin Kasalvechio të Pulias. Ndër organizatorët e veprimtarisë për shqiptarët, ishte edhe shqiptaro-italiani, gazetar dhe regjizor, Mihal Ciko.

Nga pala vendase arbëreshe u dallua për organizimin dhe drejtimin: Noe Adriano, kryetar i Komunës së Kasalvechios të Pulias; Loris Kastriota

Skanderbeg, President i Qendrës së Studimeve të Traditave Arbëreshe “Skander”, Fogjia, njëherësh i prejardhjes së gjakut të Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, dhe veprimtari Mario D’arcangelo.

Për më konkretisht, le të ndjekim veprimtarinë triditore sipas itinerarit përkatës.

## Dita e parë, e premte, 21 shtator

Në linjën Durrës – Bari udhëtojmë me traget. Nga Bari nisemi me autobus të posaçëm për në destinacion, *Kasalvechio të Pulias*. Pas rreth dy orësh mbërrim në vend, një katund ky i vogël arbëresh, shumë i bukur, i ndodhur mes një relievi kodrinor. Ky vend njihet edhe thjesht me emrin “*Katundi*”.

Siç isha në dijeni, **Kasalvechio** së bashku me **Kieutin**, të cilin e njoh mirë qysh gjatë hulumtimeve të vitit 1990, përbëjnë dy të vetmit katunde arbëreshe të *Rexhionit* Pulja të Italisë. Kasalvechio përbëhet nga rreth 2000 banorë të përzierë me italianë.

Porsa mbërrim në qendër të katundit, na presin autoritetet vendase, me në krye kryetarin e komunës (njihet si i vetmi katund) Noe Adriano. Pritja ishte modeste, zhvilluar në një ndërtesë karakteristike, që sipër kishte një mbishkrim të madh. Pikërisht, bënte surprizë të këndshme ai mbishkrim arbërisht “Tallandishat” (Dallëndyshet) për Bashkimin Kulturor Vendas, si edhe shqipërimi arbërisht i Kasalvechios: “Katundivjetri” të Pulias.

Ceremonia përuaruese e veprimtarisë “**Vëllazëria 2018**”, ishte zhvilluar pa praninë tonë, në orët e para të ditës. Kështu që, pas akomodimeve përkatëse, pasdite vijuam ndjekjen e programeve të ditës së parë. Në pasdite, në *sheshin “Papa Pio”* të Kasalvechios së Pulias, nisi punimet seanca e parë e konferencës shkencore, me temë figurën e Skënderbeut. I pari mbajti kumtesën Dr. Fatos Daci, me titull “*Origjina e Kastriotëve dhe Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”. Në vijim referoi për figurën e Skënderbeut, **Albert Koni**, drejtor i Muzeut Arkeologjik të Durrësit. Së fundi, mbajti një kumtesë për Skënderbeun, studiuesi Loris Kastriota Skanderbeg.

Të tria kumtesat u ndoqën me vëmendje nga auditori i pranishëm, duke u shënuar kështu edhe mbyllja e seancës së parë të konferencës shkencore. Në vijim të mbrëmjes së pare, u zhvillua nëpër rrugët dhe sheshet e bukura të Kasalvechios **sfilata dekorative** e të shtatë ansambleve pjesëmarrëse:

1. “**Tallandishat**” e katundit Kasalvechio; 2. “**Miqësia**” e Gramshit të Shqipërisë; 3. “**Yllazët rëgjënda**” të katundit Ururi; 4. “**Kreshnikët e lirisë**” të katundit Shën Benedikti Ullanova; 5. “**Grupi arbëresh**”

**Kieuti**” i katundit me të njëjtin emër; 6. **“Proloko Arbëria Lungro”** i katundit Ungra. Sfilatën dekorative e bënë shumë interesante ato rrugë mbresëlënëse të Kasalvekiës, si: *“Menoti”*, *“Ururi”*, *“Guliano Markonti”*, *“Roma”*, *“Trieste”*, *“Vittorio Veneto”* etj.

Nga **sfilata** e ansambleve, veçojmë **“Kreshnikët e lirisë”** të *Shën Benedikti Ullanova*.

Si zakonisht në raste të tilla, **sfilata** u karakterizua nga një festivitet i madh, në prani të banorëve vendas, **arbëreshë** dhe **italianë**, si edhe të ardhur nga mbarë katundet arbëreshe, të cilët kishin mbushur anët e rrugëve dhe ballkonet e shtëpive.

Në përfundim të **sfilatës**, u zhvillua **manifestimi i madh**. Sakaq, të gjithë ansamblet u grumbulluan në Sheshin *“Liberta”* të Kasalvekiës, duke performuar me këngë dhe valle arbëreshe e shqiptare. Këtu do të veçoja ansamblin e katundit Ungra. Lidhur me Ungran, kujtoj **ekspeditën e vitit 1993**, posaçërisht kërkimet folklorike në dhjetë fshatra të Kalabrisë (së bashku me kolegët Xhagolli dhe Çollaku).

Këtu, përreth një muaj, e patëm vendqendrimin te *Veskovi i Kalabrisë*, i nderuari **Erkole Lupinaçi**, njëherësh njohës dhe dashamirës i zjarrtë i folklorit arbëresh. Në Ungra punuam më së shumti me një ansambël arbëresh prestigjioz, *“Paradosis la Tradicione”*, me drejtues **Gionbadista Rennis**.

Gjatë dy veprimtarive të sapopërkruara, **sfilata** nëpër Kasalvekië dhe **manifestimi** në Sheshin *“Liberta”*, spikati edhe një ansambël, por jo arbëresh. Ky ishte Grupi folklorik *“Ethnos”*, kryesisht nga fshati italian Luçera. Përbënte një formacion artistiko-folklorik të këndshëm, përmes një grupvazhsh që vallëzonte me *fustanbardha të gjata*. Ansambli drejtohej nga koreografa shqiptare **Brumilda Lato**, me gulim të kahershëm në katundin arbëresh Akuifirmoza.

Pas atij *manifestimi* afro 90 minutësh, ansamblet largohen nga sheshi *“Liberta”* dhe, sërish përmes **sfilatës** nëpër rrugët e Kasalvekiës, zhvendosen në sheshin më të madh të katundit, *“Santa Maria delle Grazie”*. Këtu ishte ngritur një skenë e madhe, ku shndriste fjala *“Vëllazëria”*.

Gjatë darkimit të ansambleve e të ftuarve të shumtë, në prani edhe të atyre dhjetëra mijë shikuesish, u zhvilluan në skenë manifestime të shumta folkloriko-artistike. Posaçërisht vallëzimet e improvizuara në sheshin para skenës krijuan më së shumti imazhe sa artistike, aq edhe bashkëmiqësore. Kësisoj, deri në orët e vona të natës gumëzhiti Kasalvekië, duke gjurmuar mbresa relaksesh të pashlyera.



## Dita e dytë, e shtunë, 22 shtator

Gjatë paradites, në mjediset e shkollës së Kasalvekiës, u përurua ekspozita e piktorit shqiptar *Leka Rudho*, me tematikë nga *kalatë shqiptare dhe portrete të Skënderbeut*.

Në pasditen e dytë të këtij festimi zhvilloi punimet *seanca e dytë e konferencës shkencore*, në sheshin “*Papa Pio*”. Nga studiuesit e programuar, i pari referoi Prof. Dr. **Bardhosh Gaçe**, me kumtesën “*Skënderbeu dhe moti i madh i shqiptarëve në krijimtarinë popullore*”.

Kumtimi i dytë u mbajt nga unë, sipas trajtesës së përshkruar më sipër. Me këtë rast, përfitoj të bëj prezent dy anashkalime. *Së pari*, në pragfillim të kumtimit, i dorëzova moderatorit të seancës, **Mario D’arcangelo**, një kopje të plotë të kumtesës së bashku me CD përkatëse. Së dyti, në përfundim të kumtimit, pasi falënderova *Bardhosh Gaçen* dhe *Mihal Cikon* për ftesëmarrjen në këtë manifestim, **i dhurova Qendrës së Studimeve të Traditave Arbëreshe “Skander” – Fogjia**, përmes Presidentit të saj *Loris Kastriota Skanderbeg*, **kolanën prej gjashtë vëllimesh “Etnokoreografi (2008-2012)”**, të cilat përfshijnë botimin e shkrimeve të mia, gjatë një periudhe 47 – vjeçare (1965 – 2012).

Në shenjë falënderimi, kryetari i Komunës së Kasalvekiës, *Noe Adriano*, dhe *Loris Kastriota Skanderbeg*, **më dhuruan emblemën “Vëllazëria”**, simboli i veprimtarisë së Kasalvekiës, 2018.

Në mbyllje të seancës së dytë dhe të fundit të konferencës shkencore, u shfaq për të pranishmit *dokufilmi “Jeta dhe emigracioni në katundin arbëresh Shën Sofia, Kalabri”*, me autor **Konte Angelo**. Filmi ngjalli kërkshëri edhe nga analizat, sa tradicionale aq edhe bashkëkohore, që bënë *autorët* dhe relatori *Loris Kastriota Skanderbeg*.

Në përfundim të konferencës shkencore, teksa edhe sapo kisha mbajtur kumtesën, e ndjeva veten shumë të lehtësuar. Kjo ngase pata kaluar lodhje të madhe për përgatitjen e saj në një kohë të shkurtër, dhe nga ana tjetër, sepse do ta përfshija në shumëdimensionalin e vëllimit objekt, “**Horizonte etnokulturore**”.

Kësisoj, posaçërisht pas mbajtjes së kumtesës, kalova emocione të përmallshme, **teksa u takova pas 28 vitesh me dy miq shumë të ngushtë, bashkëshortët Nina dhe Mario Massaro**. Kujtuam atë kohë, kur së bashku me kolegun Shkreli, qemë të ftuar, përmes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nga shoqata kulturore arbëreshe “*Gjaku i shprishur*” – Kieuti, me President **Prof. Massaro**, për të kryer një ekspeditë folklorike dhe veprimtari artistike tek arbëreshët e Italisë. Kaluam për më

shumë se një muaj në familjen Massaro, kryesisht në katundin arbëresh Kieuti.<sup>2</sup> Me këtë rast, nuk mund të lë pa shënuar faktin se në prani të auditorit, gjatë parambajtjes së kumtesës, e falënderova Prof. Massaron, çka u prit me duartrokitje, si njëri ndër personalitetet e shquar të botës arbëreshe në Itali.

Në vijim të mbrëmjes së dytë të **veprimtarisë kulturore “Vëllazëria 2018”**, u zhvillua, po me atë pompozitet si në mbrëmjen e parë, **sfilata** e ansambleve pjesëmarrëse nëpër rrugët dhe sheshet e Kasalvekijs, sikundër edhe manifestimi në sheshin “Liberta”.

Në fund të mbrëmjes së dytë, sërish në sheshin “*Santa Maria delle Grazie*”, darkuam duke ndjekur një koncert të madh. Këtë radhë performuan pothuajse të gjitha ansamblet pjesëmarrëse, duke debutuar secili me nga një program të zgjedhur. Bëri përjashtim ansambli “*Miqësia*” i Gramshit me një program të zgjeruar dhe të larmishëm. Surpriza më e madhe e kësaj mbrëmjeje, mbase e krejt **veprimtarisë kulturore “Vëllazëria 2018”**, ishte debutimi si i ftuar i ansamblit vokalo-instrumentor, me emrin “**Rrokarbëresh, Peppa Marriti Band**”, me udhëheqës artistik, kitaristin dhe kantautorin e madh (sipas ndjesive të mia) **Konte Angelo** (në formacion: tri kitara, një violinë dhe një bateri).

Këtu mësova se ç’është në përgjithësi **rroku** si formacion muzikor modern dhe ai arbëresh në veçanti. Nga ana tjetër, meditova: **si është e mundur që një grupim i tillë amator, të shpaloste vlera të mahnitshme profesionale?!**

Nga ansambli, për nga interpretimi dhe krijimtaria, meritat më të mëdha i pati “*Konte i vogël për nga shtati, por shumë i madh për nga kontributi*”, siç ua thashë me humor edhe gjatë një takimi ndejeje.

**Repertori vokalo-instrumentor i ansamblit ishte i mëkuar nga traditat muzikore arbëreshe.** U ringjallën në memorien time këngë të tilla të konsoliduara nga tradita arbëreshe, si: “*Moj e bukura More*”, “*Kenka e Skanderbeut*”, “*Kostandini e Jurendina*”, “*Konstandini i vogëlith*”, “*E kush ja tha sat’emë*”, “*Kapile, moj kapile*”, “*Do t’isha zog*” etj.

Për më konkretisht, formacioni “*Peppa Marriti Band*”, **interpretoi në stilin rrokarbëresh** këngët “*Rimi mirë se jam e vemi*”, “*Gjurmët*”, “*Lule, lule, maco-mac*”, “*Nata e parë e martesës*” etj. Sikundër performoi jo pak këngë shqiptare, gjithmonë në stilin e rrokut, si: “*25 gërshetat*” etj., apo këngë kosovare, si: “*Xhamadani vija-vija*” etj. Ishte kjo një krijimtari muzikore e cila rrezatoi ndjeshëm statuskuonë e mirëfilltë të intonacioneve

arbëreshe, shqiptare, kosovare. Për më tej, muzika e atij formacioni dëshmoi europianizim dhe modernitet në kulturën arbëreshe dhe mbarëkombëtare.

Refleksionet muzikore nxisnin pa pushim artistët popullorë të ansambleve dhe mbarë të pranishmit, për vallëzime spontane në sheshin para skenës. **Ekzaltim dhe hipnotizim i paparë.** Sikundër edhe mua, në fokusin e kësaj hareje, *më rrëmbeu vala e të kërcyerit*, teksa, për një çast, pranova ftesën e *balerinës Brumilda*. Ia befa përmes ndonjë motivi kërcimi arbëresh, ashtu me ato kryqëzimet e vogla të hapave, të cilat i kam pasur për zemër t'i luaja në raste të tilla.

Për ansamblin, nuk mund të anashkalohen edhe ato *harmonizime e gjestikulime plastike shpërthyes*, të cilat i maturonin interpretuesit, sikur të ishin artistë të hollivudit amerikan!

Qenë pikërisht *ndjesi të tilla emocionale*, që më nxitën të shkoj në skenë, **duke u transmetuar të pesë muziktarëve të shquar** vlerësimet e mia. U rreka t'i stigmatizoj tharmet refleksionuese me arritje atributësh për nga: **mençuria, brishtësia, luajaliteti, lirshmëria, perfeksioni, monumentaliteti, mëvetësia krijuese, rrugëtimi folklorik, forca komunikuese dhe vlerat e patjetërsueshme.**

Dekorativiteti i buçimave të fishekzjarreve, do të fiksonin një orë të vonë të natës, çka do të shënonte edhe mbylljen e atij **festiviteti të paparë.**

I lumtë ansamblit **“Rrokarbëresh Peppa Marriti Band”**, me në krye Konte Angelon!

## Dita e tretë, e dielë, 23 shtator

### “Vëllazëria 2018”

Kjo ditë shënon edhe përfundimin zyrtar të veprimtarisë kulturore.

Orët e para të mëngjesit i kaluam duke soditur bukuritë e rrugëve dhe shesheve të katundit Kasalvequio. Me këtë rast, do të fiksoja edhe një kujtim nga Kasalvequio.

Sipas programit, për disa orë zhvilluam vizita në katundet e afërta të Kasalvequios, si: *Kasalnuovo, Kastelnova* etj. Më mbeti një *peng!* Me keqardhje nuk m'u mundësua një vizitë në katundin tim të dashur dhe të përmallshëm, **Kieutin!**

Gjatë drekimit të përbashkët dhe përfundimtar, u krye edhe përmbyllja ceremoniale e **veprimtarisë kulturore “Vëllazëria 2018”**. Përsëndetjen e rastit e mbajti nikoqiri i shtëpisë, kryetari i Bashkisë *Noe Adriano*. Me këtë rast, u shpërndanë dhurata, sikundër patëm shkëmbime librash me miq e kolegë.

Pasдите u nisëm për në Bari dhe më pas, përmes traqetit, udhëtua  
natën për në Shqipëri.

Me kaq do të mbylleshin mbresat e mira të mbajtjes së kumtesës dhe  
të krejt asaj **veprimtarie**. Kësisoj, do të zbardhej e gjashta vendndodhje tek  
arbëreshët e Italisë: **1990, 1992, 1993, 2000, 2003** dhe së fundi **2018**.

Tiranë, tetor 2018